



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2021

VENDIM
Nr. 440, datë 04.10.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3 e 94/1 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

V E N D O S I :

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Olti Skrame, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, çështjen civile me Paditës: {...}; Të paditur: {...}, {...}; Objekti: “Shpërblimi i dëmit material të shkatërrimit të banesës dhe orendive të ndodhura në të si rezultat i ndërimit të dy pallateve shumëkatëshe, në lindje dhe në perëndim të pronës time, në masën 6.667.348 lekë”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SARANDË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Marjola Beluli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vjedhje me dhunë” dhe “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, parashikuar nga nenet 139 e 22 dhe 279 e 50/ç të Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjergji Baçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur”, parashikuar nga neni 101/1 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Arben Lera, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; I pandehur: {...}; Akuza: “Plagosje e rëndë me dashje”, kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 88/1 e 25 të Kodit Penal” .

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Eglantina Mikani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; I pandehur: {...}; Akuza: “Vrasje me dashje”, e mbetur në tentativë dhe “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyeshe dhe të municionit”, parashikuar nga nenet 76, 22 e 278/1 të Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Trafikim i armëve dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal”.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës nr.613 prot., datë 27.07.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, për caktimin e një gjyqtari, në çështjen administrative që iu përket palëve:

1. Padiçese: {...}; i paditur: {...}, etj.; objekti: “Sigurimi i padisë duke urdhëruar sekuestrimin e dosjes gjyqësore me palë dhe objekt: padiçese {...}, {...}, të paditur {...}, {...}, {...}, {...}; objekti: “Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur pezullimin e vendimi për dënim me gjobë datë 14.07.2021, komunikuar më datë 20.07.2021 dhe me nr.serie 00092 të vendosur nga Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Sarandë, etj.”.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Toro, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Nazmi Troka dhe Iliba Bezati, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me Padiçes: {...}, {...}, etj.; E paditur: {...}; Objekti: “Shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror, etj.”

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me Padiçes: {...}etj.; I paditur: {...}; Objekti: Përmbushje detyrimi kontraktor, sigurim padie etj.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Iliba Bezati, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me Padiçes: {...}; Të paditur: {...}, {...}, etj.; Objekti: “Njohje pronar të shtetit shqiptar, etj.”

4. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Skënder Damini, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Ndhimë për kalim të paligjshëm të kufirit”.

5. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...}, etj.; Akuza: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 283, 242, 302-25 të Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Valbon Çekrezi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Neni 283/1 i Kodit Penal”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 143/2 i Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT TIRANË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë, Arta Duka dhe Dritan Hasani, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Tiranë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, etj.; akuza: "Vrasje me paramendim, mbetur në tentativë" dhe "Mbajtje pa leje dhe përdorim i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit".

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR